



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 33/2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, anëtarë, përkitazi me ankesën e Shtabi Zgjedhor i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), në seancën e mbajtur me 02.11. 2009, mori:

**VENDIM**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

**ARSYETIMI**

Shtabi Zgjedhor i PDK-së në Prishtinë më 26.10.2009 ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se në gjithë Prishtinën, Lidhja Demokratike e Kosovës – dega në Prishtinë ka grisur dhe vendosur posterat e tyre në hapësirat e PDK-së.

**FAKTET**

Më 26.10.2009, Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP) ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga Kryetari i Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa në Shtabin Zgjedhor të PDK-së për Prishtinë, z. Naser Canolli, duke pretenduar se përfaqësuesit e subjektit politik të LDK-së, kanë bërë shkelje ligjore të ligjit për Zgjedhjet Lokale nr.03/L-72 dhe akteve tjera të aprovuara nga KQZ, si Kodi Etik për Fushatën Zgjedhore etj.

Pretenduesi i kësaj ankese ka bashkangjitur edhe dy foto të skanuar, me kualitet të dobët duke mos specifikuar një përshkrim të hollësishëm duke përfshirë vendin e ngjarjes dhe kohën e saktë.

## ANALIZË

Jurisdiksioni i KZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe pika (c) parasheh si vijon:

- (b) *një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar;*
- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat janë në posedim të ankuesit.*

KZAP-i vlerëson se Ankesa është e parregullt për faktin se nuk përmban të gjitha elementet e detyrueshme të parashikuara në dispozitat e neneve 3.6 pika (b) dhe pika (c), përkatësisht një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar si dhe hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 33/2009 më datën 2.11.2009.

